

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8286
E enjte, 23 prill 2026
Çmimi 0.50 €

Trumpi e zgjat
armëpushimin me
Iranin, por e mban
në fuqi bllokadën ndaj
porteve iraniane

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ZGJEDHJET E MUNDSHME E VËNË KQZ-në PËRBALLË PROBLEMEVE TË PAZGJIDHURA

FAQE 4-5



Telashet e proceseve zgjedhore të vitit të shkuar në Kosovë nuk do të mund të gjejnë zgjidhje sivjet nëse vendi shkon në zgjedhje parlamentare brenda pak javësh, për herë të tretë në pak më shumë se një vit. Deputetët e

Kuvendit të Kosovës kanë kohë deri më 28 prill që ta zgjedhin presidentin e ri të shtetit - në rast të kundërt zgjedhjet e reja të parakohshme duhet të mbahen brenda 45 ditësh. Numërimi i votave të kandidatëve për deputetë,

votimi jashtë Kosovës dhe angazhimi e trajnimi i stafit që merret me mbarëvajtjen e zgjedhjeve, janë vetëm disa nga telashet e identifikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që shoqëruan dy palë zgjedhje të përgjithshme

AKTUALE



**HAXHIU: E KAM OFRUAR POZITËN
E KRYEPARLAMENTARES QË TË
MOS SHKOJMË NË ZGJEDHJE** F. 3

**ORCA: QEVERIA RREZIKON
PAVARËSINË E AGJENCISË SË
KOSOVËS PËR AKREDITIM** F. 6

**FILLON PUNA PËR HARTIMIN E
STRATEGJISË PËR PËRMIRËSIMIN
E QASJES NË DREJTËSI NË
SISTEMIN PROKURORIAL** F. 5

EKONOMI



**KUSH DO TË KOMPENSOHET NGA
PASAKTËSITË NË NJEHSORËT
ELEKTRIKË?** F. 8

**ZYRTARIZOHET MARRËVESHJE
BASHKËPUNIMI PËR ZHVILLIMIN
E AKADEMISË SË TURIZMIT NË
KOSOVË** F. 8

SPORT



**KOSOVA NGJITET NË POZITËN
MË TË MIRË HISTORIKE
NË RANGLISTËN E FIFA-S** F. 11



**KURTI PARALAJMËRON
ZGJEDHJE TË
"NJËPASNJËSHME" NËSE
NUK ARRIHET MARRËVESHJE
DOMOSDO PËR PRESIDENT** F. 3



**IKD-ja S'MERR PJESE
NË KONSULTIMET
'FORMALE' PËR
BYRONË: PO TENTOHET
TË PROCEDOHEM
ME NGUTI** F. 7

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mbz: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

TRUMPI E ZGJAT ARMËPUSHIMIN ME IRANIN, POR E MBAN NË FUQI BLOKADËN NDAJ PORTEVE IRANIANE

WASHINGTON, 22 PRILL - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, njoftoi të martën vonë se do ta zgjasë njëanshëm armëpushimin me Iranin, por shtoi se bllokada e porteve iraniane, e cila e ka zemëruar Teheranin, do të mbetet në fuqi. "Bazuar në faktin se Qeveria e Iranit është seriozisht e përçarë, gjë që nuk është e papritur, dhe me kërkesë të marshallit Asim Munir dhe kryeministrit të Pakistanit, Shehbaz Sharif, na është kërkuar ta pezullojmë sulmin tonë ndaj Iranit deri në momentin kur udhëheqësit dhe përfaqësuesit e tyre të mund të dalin me një propozim të unifikuar", shkroi Trumpi në "Truth Social" të martën vonë. Trumpi shtoi se do ta "zgjasë armëpushimin deri në momentin kur propozimi i tyre të dorëzohet dhe bisedimet të përfundojnë, në një mënyrë apo tjetër".

Ai nuk dha ndonjë afat të saktë kohor.

Nuk është ende e qartë nëse Teherani do ta zgjasë armëpushimin.

Një këshilltar i kryetarit të fuqishëm të Parlamentit të Iranit e quajti zgjatjen e armëpushimit "manovër për të fituar kohë për një sulm të befasishtëm" dhe theksoi se

Teherani duhet ta marrë iniciativën, pa dhënë hollësi. Zëdhënësi shtoi se bllokada e tanishme amerikane e porteve iraniane është "e njëjtë me bombardim dhe përgjigja ndaj saj duhet të jetë ushtarake". Trumpi kishte paralajmëruar paraprakisht se nuk donte ta zgjaste armëpushimin e përkohshëm me Iranin, i cili pritej të skadonte sot, pasi Uashingtoni priste të kuptonte nëse bisedimet me Teheranin do të vazhdonin.

Një zyrtar i Shtëpisë së Bardhë më vonë njoftoi se nënpresidenti JD Vance nuk do të udhëtonte për në Islamabad të martën për një raund të dytë negociatash të ndërmjetësuar nga Pakistani. Ai nuk tha nëse po shqyrtohej ndonjë datë e re për udhëtimin e tij.

Blokada mbetet në fuqi

Trumpi shtoi në postimin e tij se ShBA-ja do ta vazhdojë bllokadën ndaj porteve iraniane, e cila deri tani ka çuar në sekuestrimin e të paktën dy anijeve nga marina amerikane. Teherani ka thënë se nuk do t'i rifillojë bisedimet pa u hequr bllokada, ndërsa ShBA-ja ka deklaruar se nuk do ta heqë atë derisa të nënshkruhet një marrëveshje paqesë.



Pakistani u ka bërë thirrje ShBA-së dhe Iranit që ta zgjasin armëpushimin, por thuhet se Teherani po shqyrton mundësitë dhe po pret të shohë nëse kushtet e tij - përfshirë heqjen e bllokadës dhe njohjen e të drejtës për pasurim të uraniumit - do të plotësohen. Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme të Iranit, Esmail Baqaei, e dënoi ndalimin e një cisterne iraniane nga forcat amerikane të hënën si dhe sekuestrimin e një anijeje tjetër një ditë më parë, duke i quajtur "pirateri detare dhe terrorizëm shtetëror" dhe tha se këto veprime ngrënë pikëpyetje për përkushtimin e Uashingtonit ndaj bisedimeve serioze. Irani e ka bllokuar hyrjen në

Ngushticën e Hormuzit për të gjitha anijet, përveç të vetave ose atyre që Teherani i lejon të kalojnë.

"Kartat e reja" të Iranit

Kryetari i Parlamentit iranian, Mohammad Baqer Qalibaf, i cili është gjithashtu negociatori kryesor i Iranit, shkroi në X të hënën se Teherani është "i gatshëm të zbulojë karta të reja" në luftën me ShBA-në dhe Izraelin, duke e akuzuar Trumpin për "rrethim dhe shkelje të armëpushimit", sepse po përpiqet t'i shndërrojë bisedimet në "dorëzim ose ta arsyetojë rifillimin e luftës". Trumpi ka kërcënuar se do ta rifillojë luftën dhe do ta sulmojë

infrastrukturën civile iraniane, si ura dhe centrale elektrike, nëse Teherani nuk i pranon kushtet e tij.

Raundi i parë i bisedimeve në Islamabad më 11-12 prill nuk arriti të prodhojë marrëveshje për përfundimin e plotë të luftës, e cila filloi më 28 shkurt kur sulmet ajrore të ShBA-së dhe Izraelit goditën caqe në gjithë Iranin.

Tensionet në rajon mbeten të larta, ndërsa anijet e mallrave janë grumbulluar në Gjirin Persik për shkak të bllokadës.

Teksa trafiku detar është ngadalësuar pothuajse plotësisht, disa anije thuhet se kanë kaluar përmes Ngushticës së Hormuzit.

Të dhënat nga platforma e gjurmimit të anijeve MarineTraffic treguan se një anije e quajtur Ean Spir, pa flamur dhe pa pronësi të njohur, kaloi nëpër këtë rrugë ujore të martën, pasi më parë ishte ankoruar në një port iranian.

Një anije tjetër pa flamur, Lian Star, gjithashtu duket se ka kaluar përmes ngushticës, sipas të dhënave.

Sipas analistëve të transportit detar, zakonisht rreth 140 anije kalojnë nëpër këtë ngushticë, e cila përbën rreth 20 për qind të transportit global detar të naftës dhe gazit.

KRIZA NË HORMUZ FUQIZON KORRIDORIN E MESËM

TEHRAN, 22 PRILL - Përderisa përpjekjet diplomatike po hasin në vështirësi për ta stabilizuar qasjen në Ngushticën e Hormuzit mes tensioneve ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Iranit, tregtia euroaziatike po ridrejtohet gjithnjë e më shumë nga alternativat tokësore, me Rrugën e Transportit Trans-Kaspik - e njohur edhe si Korridori i Mesëm që po shfaqet si një rrugë kyçe për diversifikimin e logjistikës në Euroazi.

Më 2023 Banka Botërore e përshkroi Korridorin e Mesëm si një rrugë me rëndësi strategjike, por të kufizuar nga aspekti strukturor. Teksa fragmentimi gjeopolitik, i nxitur pjesërisht nga lufta e Rusisë në Ukrainë, ka rritur kërkesën për korridore alternative, Banka Botërore theksoi se qëndrueshmëria afatgjatë e këtij korridori kërkon investime të koordinuara, heqjen e pengesave infrastrukturore dhe përmirësimin e procedurave doganore ndër-kufitare dhe atyre të transportit.

Për t'i adresuar këto barrierat rrugore, Banka Botërore dhe partnerët e saj më 14-15 prill u

zotuan për 3.3 miliardë dollarë për forcimin e hallkave kryesore që mungojnë përgjatë korridorit, përfshirë 1.9 miliardë dollarë për Kalimin Hekurudhor Verior të Stambollit në Turqi dhe një investim prej 1.4 miliardë dollarësh për rindërtimin e autostradës Karagandi-Zhezkazgan në Kazakistan.

Po të njëjtën ditë kur u bë publik ky njoftim, zëvendës-presidenti i Turqisë, Cevdet Yılmaz, theksoi rëndësinë e investimeve të tilla gjatë një takimi në Astana. "Korridori Verior [përmes Rusisë] është bërë i paparashikueshëm për shkak të tensioneve gjeopolitike. Rruga jugore po i shtyn limitet e kapacitetit të saj", tha ai. "Kjo situatë e ka bërë Korridorin e Mesëm jo një alternativë, por një zgjedhje të domosdoshme".

Dosym Satpayev, drejtor i Grupit për Vlerësimin e Rrezikut në Almati - institut i pavarur që analizon rreziqet politike, korrupsionin dhe proceset e politikës së jashtme në rajon - tha se lufta e Rusisë në Ukrainë dhe sanksionet që pasuan kanë thelluar varësinë globale nga rrugë kryesore detare sikurse Ngushtica e Hormuzit. Por, kriza



aktuale mund të ketë pasoja afatgjatë për tregtinë globale. "Edhe nëse Ngushtica e Hormuzit rihapet, besoj se imazhi i saj si një rrugë e qëndrueshme transporti dhe logjistike është dëmtuar për shumë vjet, nëse jo përgjithmonë", tha Satpayev. "E njëjta gjë vlen edhe për stereotipin se vendet e Gjirit Persik dhe të Lindjes së Mesme mund të garantojnë furnizime të qëndrueshme të burimeve energjetike dhe mallrave të tjera përmes Ngushticës së Hormuzit".

Pasiguria tashmë po riformëson çmimet globale dhe sjelljen tregtare, shtoi ai, duke thënë se

një "rrezik për sigurimet detare" ka gjasë të mëdha të përfshihet në çmimet e naftës dhe të plehrave azotike. "Rreth 25-35 për qind e furnizimeve globale me plehra kalojnë përmes Ngushticës së Hormuzit, dhe kjo pashmangshëm do të reflektohet në çmimet në treg. Prandaj, shumë vende do të kërkojnë t'i diversifikojnë rrugët pavarësisht se si zhvillohet situata. Me shumë gjasë, paqëndrueshmëria do të zgjasë për një kohë të gjatë, që do të thotë se rreziqet do të mbeten të larta. Dhe kjo është e keqe për biznesin, sepse biznesi ka nevojë për parashikueshmëri".

Një faktor kyç pas rritjes së tërheqjes së Korridorit të Mesëm, sipas Satpayev, është stabiliteti relativ i rajoneve nëpër të cilat kalon ky korridor. Pavarësisht prej konflikteve përreth, Azia Qendrore dhe Kaukazi kanë "treguar stabilitet në kushte të kaosit gjeopolitik". "Kjo ka rritur interesin për të si një platformë për projekte transporti dhe ato logjistike", tha ai. "Si rezultat, statusi i rajonit është rritur në nivel global".

Korridori i Mesëm u përshtatet të gjithëve, shtoi ai, përveç Rusisë. "Ne shohim se aktorët kryesorë gjeopolitikë po kërkojnë t'i forcojnë pozicionet e tyre në rajon, kryesisht në sferat ekonomike dhe të transportit dhe logjistikës. Kina dhe Bashkimi Evropian janë veçanërisht aktivë", u shpreh Satpayev. "Samiti i Samarkandit vitin e kaluar shfaqti interesin e BE-së për zhvillimin e Korridorit të Mesëm, përfshirë investime në qendrat rreth Detit Kaspik. Edhe Shtetet e Bashkuara po tregojnë interes për Korridorin e Mesëm, pasi synojnë qasje në materiale kritike dhe metale të rralla në Azinë Qendrore".

KURTI PARALAJMËRON ZGJEDHJE TË 'NJËPASNJËSHME' NËSE S'ARRIHET MARRËVESHJE DOMOSDO PËR PRESIDENT

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 PRILL - Kryeministri Albin Kurti ka paralajmëruar të mërkurën se Kosova do të detyrohet të mbajë zgjedhje të "njëpasnjëshme" parlamentare nëse partitë parlamentare nuk arrijë pajtueshmëri për zgjedhjen e presidentit të vendit, kur ka mbetur më pak se një javë nga mbarimi i afatit kushtetues për këtë çështje.

Kurti, i cili njëherësh është edhe kryetar i partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, tha për gazetarë se zgjedhjet e reja do t'i kushtonin vendit me humbje në vlerë dhjetëra milionë euro. "Nëse shkojmë në zgjedhje të reja nuk do të kemi zgjidhje, meqenëse sërish do të na duhet të shkojmë në zgjedhje të reja, e pas atyre sërish do të na duhet të shkojmë në zgjedhje të reja. Unë nuk e di se si mund t'i kemi 80 deputetë, prandaj është e domosdoshme të merremi vesh", tha Kurti pas një ngjarjeje në përrurimin e Klinikës së Kardiologjisë në Prishtinë.

Presidenti i Kosovës zgjidhet me dy të tretat e votave në dy raundet e para të votimit, apo me 61 vota në raundin e tretë, por nevojiten 80 deputetë në sallë që seanca të mund të mbahet.

Prandaj, nevojitet një marrëveshje mes partive parlamentare për këtë çështje, duke qenë se asnjëra parti - madje as ajo në pushtet e Kurtit me 57 deputetë - nuk e ka një

numër kaq të madh deputetësh në Kuvendin me 120 vende.

Një afat kushtetues për zgjedhjen e presidentit skadon më 28 prill dhe nëse deri atëherë nuk zgjidhet një president, Kosova do të mbajë zgjedhje të reja brenda 45 ditësh.

Deklaratat e Kurtit vijnë dy ditë pasi dështuan bisedimet mes tij dhe liderëve të dy partive kryesore opozitare, Bedri Hamzës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), e cila ka 22 ulëse, dhe Lumir Abdixhikut të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) që ka 15 ulëse.

Gjatë bisedimeve të hënën në Prishtinë, Kurti i kishte ofruar LDK-së së Abdixhikut pozitën e zëvendëskryeministrit, Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe tri ministri të tjera të paspecifikuara.

Në një ofertë tjetër, Kurti i kishte ofruar LDK-së pozitën e kryetarit të Kuvendit të Kosovës.

Që të dyja këto oferta u hodhën poshtë nga Abdixhiku.

Ndërkohë, në të njëjtën ditë, pas dështimit të marrëveshjes me Abdixhikun, kreu i PDK-së, Bedri Hamza, e hodhi poshtë si "joserioze" ofertën e Kurtit që partia e tij ta ketë kryeparlamentarin në një ujdje me LV-në.

Abdixhiku tha se nuk do të takohet më me Kurtin, ndërsa Hamza e quajti të "përfunduar" kontributin e partisë së tij për çështjen e presidentit.

Nuk është e qartë se si Kurti mund t'i bindë ata të rikthehen në tryezën e bisedimeve para se të soset afati kushtetues për

zgjedhjen e presidentit të ri të Kosovës. Në komentet e tij të mërkurën, Kurti nuk shpjegoi nëse do t'i kontaktojë sërish.

Ndërkohë pasi Vjosa Osmani i mbaroi mandati në fillim të muajit dhe vendi nuk arriti ta emërojë zëvendësuesin e saj, kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu, u emërua ushtruese e detyrës së presidentit më 4 prill.

Edhe vetë Haxhiu u ka bërë thirrje partive për arritjen e një konsensusi për zgjedhjen e presidentit, duke theksuar se vendi nuk duhet të shkojë në zgjedhje të jashtëzakonshme.

Përpjekjet e mëparshme për presidentin e ri të vendit dështuan pasi asnjëra palë nuk u duk e gatshëm të bëjë lëshime. Partia në pushtet në një seancë më 5 mars kishte paraqitur dy emra për president: Glauk Konjufcën, ministrin e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe deputeten Fatmire Mullhaxha-Kollçaku, por seanca s'u mbajt në mungesë kuorumi, pasi opozita e braktisi sallën.

Të nesërmen, ish-presidentja Vjosa Osmani nxori një dekret për shpërndarje të Kuvendit dhe hapje të rrugës për zgjedhje të reja. Vetë Osmani synonte edhe një mandat të dytë, mirëpo nuk e siguroi mbështetjen e nevojshme në këtë drejtim.

Dekreti u rrëzua nga Gjykata Kushtetuese pas ankesës nga qeveria.

Gjykata tha se dekreti nuk kishte asnjë efekt juridik dhe e përcaktoi 28 prillin si afat të fundit për zgjedhje të presidentit.

Haxhiu: E kam ofruar pozitën e kryeparlamentares që të mos shkojmë në zgjedhje

Ushtruesja e detyrës së presidentes, njëkohësisht kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Albulena Haxhiu, ka thënë se e ka ofruar pozitën e kryeparlamentares që vendi të mos shkojë në zgjedhje. Ajo ka thënë se ka kërkuar nga të gjitha grupet parlamentare të bëjnë përpjekje maksimale që vendi të mos shkojë në zgjedhje të jashtëzakonshme, por që t'y jepet mundësia takimeve dhe një marrëveshjeje për çështjen e zgjedhjes së presidentit apo presidentes. "Së pari, mendoj që nuk është mirë që vendi të shkojë në zgjedhje të jashtëzakonshme. Unë e kam shpjeguar disa herë që kemi shumë punë para vetes, shumë reforma që duhet t'i shtyjmë përpara, një agjendë legislative ambicioze e Qeverisë së Republikës së Kosovës që përmban diku 174 projektligje, secili projektligj më i rëndësishëm se tjetri. Por edhe për shumë aspekte të tjera, jo vetëm ato të brendshme, por edhe të jashtme. Në këtë drejtim, unë kam kërkuar edhe publikisht që të gjitha grupet parlamentare të bëjnë përpjekje maksimale që vendi të mos shkojë në zgjedhje të jashtëzakonshme, por që t'u jepet mundësia takimeve dhe një marrëveshjeje për çështjen e zgjedhjes së presidentit apo

presidentes së vendit. Ka qenë shumë e rëndësishme që të dëshmohet vullnet, gatishmëri, seriozitet, përkushtim maksimal që ta tejkalojmë këtë sfidë që e kemi para vetes. Për faktin se vitin e kaluar ne kemi humbur shumë me moskonstituimin, fillimisht të Kuvendit të Republikës së Kosovës, pastaj me mosvotimin e qeverisë, edhe me mosvotimin e kryeministrit Kurti dhe të kandidatit tjetër Glauk Konjufca", ka thënë Haxhiu.

Ajo ka thënë se beson se gjatë këtyre ditëve do të ketë sërish takime për presidentin. "Unë i pashë me shqetësim deklarimet e subjekteve opozitare që thoshin që kjo temë tashmë është e mbyllur. Si ka mundësi të jetë tema e mbyllur për sa kohë ne kemi afat deri të hënën, përkatësisht më 27 prill. Ne e kemi ofruar edhe pozitën e kryetarit të Kuvendit, sepse çka na duhet pozita e kryetarit të Kuvendit nëse dikush e kërkon këtë dhe nëse kjo parandalon zgjedhjet e jashtëzakonshme. Mendoj se mungesa dhe refuzimi i të gjitha propozimeve, ofertave që kryeministri Kurti i ka bërë në drejtim të partive opozitare, PDK-së dhe LDK-së, nuk i ndihmon vendit. Ne nuk u frikësohemi zgjedhjeve, por mendoj që nuk ka të bëjë kjo me kush është më trim e kush është më i guximshëm, por a janë zgjedhjet në interes të qytetarëve. Personalisht mendoj se nuk janë në interes të qytetarëve të Republikës së Kosovës", ka thënë Haxhiu.



ZGJEDHJET E MUNDSHME E VËNË KQZ-në PËRBALLË PROBLEMEVE TË PAZGJIDHURA

PRISHTINË, 22 PRILL - Telashet e proceseve zgjedhore të vitit të shkuar në Kosovë nuk do të mund të gjejnë zgjidhje sivjet nëse vendi shkon në zgjedhje parlamentare brenda pak javësh, për herë të tretë në pak më shumë se një vit.

Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë kohë deri më 28 prill që ta zgjedhin presidentin e ri të shtetit - në rast të kundërt zgjedhjet e reja të parakohshme duhet të mbahen brenda 45 ditësh.

Numërimi i votave të kandidatëve për deputetë, votimi jashtë Kosovës dhe angazhimi e trajnimi i stafit që merret me mbarrëvajtjen e zgjedhjeve, janë vetëm disa nga telashet e identifikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që shoqëruan dy palë zgjedhje të përgjithshme (të mbajtura më 9 shkurt dhe 28 dhjetor 2025), si dhe dy runde të zgjedhjeve lokale (më 12 tetor dhe 9 nëntor 2025).

Për t'i adresuar ato, KQZ-ja ka rekomanduar që të ndryshohen Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregullat Zgjedhore, por një gjë të tillë do ta pamundësonte mbajtja eventuale e zgjedhjeve të parakohshme këtë vit, ndërmjet 31 majit dhe 7 qershorit.

Alban Krasniqi, anëtar i KQZ-së nga radhët e partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje (LV), thotë se ndryshimet ligjore

kërkojnë kohë për t'u testuar e për t'u zbatuar, pa rrezikuar integritetin e procesit zgjedhor. Kështu, sipas tij, pamundësia për adresimin e mangësive nga proceset e kaluara rrezikon përsëritjen e tyre. "Në rrethana të tilla, fokusi i KQZ-së pashmangshmërisht zhvendoset nga reforma afatgjatë, te menaxhimi emergjent i aktiviteteve të domosdoshme. Kjo do të thotë se shumë nga problematikat e zgjedhjeve të kaluara mund të përsëriten, pasi koha e pamjaftueshme kufizon mundësinë për ndryshime thelbësore dhe zbatimin e tyre", shprehet Krasniqi për Radion Evropa e Lirë (REL).

Edhe përfaqësuesi i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në KQZ, Ilir Gashi, shpreh të njëjtin qëndrim. "Zgjedhjet e shpejta nuk lejojnë ndërhyrje apo përmirësim të dukshëm të defekteve që kanë përcjellë zgjedhjet e kaluara", thotë ai për REL-in.

Sipas hulumtuesit të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Eugen Cakolli, është joreale të pritë adresimin e problemeve në thelb, kur vendi mund të shkojë në zgjedhje prapë brenda një kohe të shkurtër.

Cakolli thotë se ndryshimet në legjislacionin zgjedhor "kërkojnë kohë dhe stabilitet politik", dhe se praktikant ndërkombëtare sugjerojnë që ato të bëhen të paktën 6-12

muaj para një procesi zgjedhor. "Çfarë mund të bëhet në një afat kaq të shkurtër lidhet më shumë me menaxhimin e procesit - për shembull, përzgjedhja më e kujdesshme e stafit zgjedhor, rritja e standardeve të trajnimit dhe shmangia e përsëritjes së problemeve të evidentuara nga stafi i njëjtë", pohon ai për REL-in.

Cakolli thotë se duhet angazhim serioz për reformë. "Përndryshe, rrezikojmë që i njëjti model të prodhojë të njëjtat probleme në vazhdimësi, ndërsa besimi në proces gradualisht të dobësohet", vlerëson ai.

Çfarë ndryshimesh duhen bërë?

Ndryshimi i Ligjit për Zgjedhjet, i bërë më 2023, ndër të tjera, u ka mundësuar votuesve që për deputetë të mund të votojnë deri në dhjetë kandidatë. Në mesin e rekomandimeve të KQZ-së është edhe kthimi në praktikën e mëparshme: atë të votimit për deri në pesë kandidatë për deputetë. Sipas Krasniqit të LV-së, përvoja në terren ka treguar se numri i lartë i kandidatëve ngadalëson procesin dhe rrit rrezikun për manipulime e gabime teknike gjatë numërimit. "Për më tepër, përzgjedhja e 10 kandidatëve krijon një ngarkesë të panevojshme për votuesit, duke e ndërlikuar vendimmarrjen e

tyre, dhe duke zbehur qëllimin e vërtetë të demokratizimit të votës. Thjeshtimi i këtij procesi do të garantonte më shumë saktësi, shpejtësi dhe transparencë në administrimin e zgjedhjeve", vlerëson anëtar i KQZ-së.

Po sipas Cakollit, ndryshimet e para tre vjetëve krijuan më shumë hapësirë për gabime në zgjedhjet e vitit të kaluar. "Kryesorja ishte mënyra e numërimit të votave preferenciale - mbi 240 mijë ndryshime gjatë rinumërimit tregojnë se kemi një problem në vetë modelin, jo thjesht në zbatim", thotë ai për REL-in. Me ndryshimin e ligjit më 2023 për herë të parë u mundësua votimi fizik në ambasada e konsullata për qytetarët me të drejtë vote që jetojnë jashtë Kosovës.

Në këtë aspekt, sipas Krasniqit, i nevojshëm është lehtësimi i procedurave për regjistrim dhe votim jashtë vendit. "Konkretisht, nevoja për rritjen e numrit të qendrave të votimit jashtë vendit, që do të ndikonte në lehtësimin e pjesëmarrjes së mërgatës në zgjedhje, dhe njëkohësisht do të ulte kostot financiare të këtij operacioni", thotë ai.

Ndërkaq Gashi i PDK-së vlerëson se ligji ka nevojë për ndryshime që përcaktojnë përdorimin e teknologjisë, "veçanërisht skanimin dhe

leximin optik të fletëvotimeve".

Çfarë shkoi keq në zgjedhjet e kaluara?

Krasniqi thotë se manipulimi i votave të kandidatëve për deputetë ka qenë ndër problemet kryesore që është evidentuar nga zgjedhjet e 28 dhjetorit. Ai shprehet se ka qenë shqetësues mosraportimi i parregullsisve nga vëzhguesit dhe ekipet e numërimit, teksa shkakton kosto shtesë financiare dhe vonesa në certifikimin e rezultateve", u konfirmuan vetëm pas rinumërimit të votave. "Për KQZ-në ky është një mësim i qartë se organizimi i mirë administrativ nuk mjafton nëse nuk ka saktësi në numërim. Prandaj, prioriteti ynë tani është ndërmarrja e masave të rrepta parandaluese që garantojnë mbrojtjen e vullnetit të qytetarëve dhe eliminojnë çdo mundësi për manipulim në të ardhmen", thotë Krasniqi.

Kurse në zgjedhjet lokale Krasniqi e ka parë problematik numrin e madh të votimit me asistencë, që nuk ka plotësuar kriteret që parasheh ligji. "Pastaj, në disa raste, mosmbërritja me kohë e pakove me fletëvotime tek votuesit e regjistruar për votim jashtë Kosovës në raundin e dytë për kryetar të komunave ishte

AMBASADORI AMERIKAN NË NATO BISEDON ME KRERËT NË KOSOVË PËR SITUATËN E SIGURISË

PRISHTINË, 22 PRILL - Ambasadori amerikan në NATO, Matthew Whitaker, është takuar me udhëheqës të lartë shtetërorë në Kosovë dhe me atë të misionit të KFOR-it me të cilët ka biseduar për situatën e sigurisë.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka biseduar me zyrtarin e lartë amerikan për mbështetjen e ShBA-së për vendin dhe për bashkëpunimin me Forcën e Sigurisë së Kosovës përmes trajnimeve dhe edukimeve si dhe "trajtjen e kapaciteteve mbrojtëse". "Duke folur për situatën e sigurisë në Ballkanin Perëndimor, kryeministri tha se ajo mbetet e brishtë për shkak se Serbia, e mbështetur nga Rusia dhe Kina, vazhdon të ndjekë politikë hegjemoniste rajonale. Ai foli edhe për armatosjen e fqinjët verior, me theks blerjet e fundit nga Rusia dhe Kina, si kërcënime për stabilitetin afatgjatë rajonal dhe fqinjësinë e mirë në Ballkan", u tha në njoftimin e lëshuar nga Qeveria e Kosovës.

Së voni, Serbia ka thënë se do të blejë pajisje të reja ushtarake, me presidentin serb Aleksandar Vučić, që ka thënë se situata e sigurisë është komplekse për shkak të "aleancës ushtarake të Prishtinës, Tiranës dhe Zagrebit".

Kosova, Shqipëria dhe Kroacia kanë nënshkruar vitin e kaluar një deklaratë për thellim të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, që Serbia e sheh si "aleancë kundër serbëve dhe Serbisë". Të tri shtetet kanë hedhur poshtë vazhdimisht këtë pretendim të Beogradit.

Më herët gjatë së martës, ambasadori Whitaker është takuar me ushtruesen e detyrës së presidentit Albulena Haxhiu. Pas takimit në Presidencën e Kosovës, përmes një njoftimi u tha se Whitaker dhe Haxhiu biseduan për zhvillimet politike, sigurinë në rajon dhe rëndësinë e "bashkërendimit të ngushtë mes aleatëve" për t'u përballur me sfidat e kohës. "Shprehja mirënjohjen time për mbështetjen e palëkundur që Shtetet e Bashkuara i kanë dhënë Kosovës ndër vite si dhe vlerësimin për angazhimin e ambasadorit Whitaker në forcimin e partneritetit tonë strategjik dhe sigurisë në rajon", tha Haxhiu.

Ambasada Amerikane në Prishtinë tha se vizita e zyrtarit amerikan është mundësi për të diskutuar për interesat e përbashkët në fushën e sigurisë. "Vizita e tij paraqet një mundësi për të diskutuar për interesat e



përbashkëta të sigurisë dhe rolin e vazhdueshëm të Kosovës në kontributin ndaj prioritetëve rajonale dhe globale të sigurisë së ShBA-së", shkroi Ambasada Amerikane në rrjetet sociale. Ndërkaq, përfaqësuesi i përhershëm i Shteteve të Bashkuara në NATO, ambasadori Matthew Whitaker, në nisje të vizitës u takua me komandantin e misionit paqeruajtës të aleancës në Kosovë, KFOR, gjeneralmajor Ozgan Ulutash. Sipas njoftimit, Ulutash e njoftoi ambasadorin amerikan për situatën e sigurisë në rajon, duke vënë në pah rolin e KFOR-it për "ruajtjen e një mjedisi të sigurt" për të gjithë njerëzit në Kosovë. "Në këtë drejtim gjeneralmajori

Ulutash shprehu mirënjohjen për kontributin e kamotshëm dhe të çmuar të ShBA-së në misionin e KFOR-it", tha misioni përmes një njoftimi. Kosova synon të bëhet pjesë e aleancës ushtarake perëndimore të NATO-s, por në këtë aleancë janë katër shtete që ende nuk e njohin pavarësinë e Kosovës teksa Uashingtoni përkrah aspiratën e Kosovës për anëtarësim në aleancë.

Kosova e konsideron qenësore aleancën me Shtetet e Bashkuara, vend që ka kontribuar në pavarësinë dhe shtetndërtimin e Kosovës. Aktualisht Forca e Sigurisë së Kosovës është në proces të shndërrimit në ushtri të plotë,

që pritet të përmbyllet më 2028. ShBA-ja e ka mbështetur nga fillimi shndërrimin e FSK-së në ushtri, por jo edhe NATO-ja, e cila ngul këmbë që FSK-ja t'u përmbahet detyrave të saj fillestare, si: reagimi ndaj krizave apo mbrojtja civile.

Prishtina, gjatë procesit të transformimit të FSK-së në ushtri, po ashtu po pajiset me armatime të reja, përfshirë ato të prodhuara në ShBA. Vendi, po ashtu, është mikpritës i bazës më të madhe amerikane në Ballkan, Bondsteel. Po ashtu, Kosova do të jetë pjesë e Forcës Ndërkombëtare Stabilizuese për Gazën.

Forca Ndërkombëtare Stabilizuese është një mekanizëm i krijuar si pjesë e nismës së Bordit të Paqes, i propozuar nga presidenti amerikan Donald Trump për arritjen e paqes në botë. Kosova është në mesin e pesë shteteve të para - së bashku me Indonezinë, Marokun, Kazakistanin dhe Shqipërinë - që janë zotuar për angazhim në këtë mision, me qëllim ofrimin e sigurisë dhe mbikëqyrjen e armëpushimit në Rripin e Gazës. Para vizitës në Kosovë ambasadori Whitaker qëndroi në Maqedoni të Veriut dhe Kroaci.

FILLON PUNA PËR HARTIMIN E STRATEGJISË PËR PËRMIRËSIMIN E QASJES NË DREJTËSI NË SISTEMIN PROKURORIAL

Prishtinë, 22 prill - Në kuadër të zbatimit të Planit të Punës së Komisionit për Çështje Normative të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) për vitin 2026, nën kryesimin e Naim Abazit, u mbajt takimi i parë i Grupit Punues për Hartimin e Strategjisë për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi në sistemin prokurorial. Në këtë takim mori pjesë edhe kryetari i Komisionit për Çështje Normative, Visar Krasniqi, i cili theksoi rëndësinë e këtij dokumenti strategjik për avancimin e funksionimit të sistemit prokurorial dhe forcimin



e besimit të qytetarëve në institucionet e drejtësisë. Gjatë takimit Abazi paraqiti draftin fillestar të Strategjisë

2026-2028 si dhe matricën për ndarjen e detyrave konkrete ndërmjet anëtarëve të Grupit Punues. Ai theksoi se procesi

është gjithëpërfshirës dhe përfshin përfaqësues nga KPK-ja dhe prokuroritë e vendit, të organizuar në nëngrupe tematike që do të trajtojnë çështje kyçe si prioritizimi i lëndëve penale, koordinimi institucional dhe normativ, komunikimi me publikun dhe palët e interesuara si dhe monitorimi dhe raportimi i zbatimit të strategjisë.

Po ashtu, anëtarët u informuan për mundësinë e organizimit të dy punëtorive të cilat do të shërbejnë për zhvillimin e mëtejshëm të draftit, së pari

përbrenda grupit punues, pastaj përmes diskutimeve dhe kontributeve nga përfaqësues të shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Në përfundim u theksua se Grupi Punues do ta vazhdojë angazhimin intensiv për finalizimin e draftstrategjisë dhe organizimin e konsultimeve publike në muajt në vijim, duke siguruar një proces transparent dhe gjithëpërfshirës që synon t'i reflektojë nevojat reale të sistemit prokurorial dhe pritshmëritë e qytetarëve për drejtësi më të shpejtë dhe më efikase.

problematikë shumë serioze", thotë ai.

Gashi konsideron se "sfidë serioze" gjatë vitit të shkuar kanë qenë "përppjekjet e pushtetit për të ndërhyrë në vendimmarrje, si dhe tentimet për të votuar jashtë kornizës ligjore". Sipas tij, vështirësi ka paraqitur edhe shpallja e zgjedhjeve të parakohshme në fundit. "Sfida të tjera kanë qenë votimi deri në 10 kandidatë - që ka vështirësuar administrimin e votës, mungesa e skanimit dhe leximit optik të fletëvotimeve, votimi me asistencë, rekrutimi i stafit... Mungesa e një drejtori të zgjedhur nga neglizhenca e pajustificuar nën drejtimin e kryetarit, si dhe ndikimi i

pushtetit kanë sjellë vështirësi. Po ashtu, edhe menaxhimi joadekuat i operacioneve zgjedhore", thotë Gashi. Por, sipas Cakollit të KDI-së, problemet me të cilat janë karakterizuar zgjedhjet e fundit në Kosovë nuk janë të reja. "Kësaj here dolën shumë më qartë në sipërfaqe", thotë ai.

KQZ-ja përballë zgjedhjeve të parakohshme

Organizimin e zgjedhjeve, kurdo që mund të shpallen ato, anëtarët e KQZ-së e shohin si obligim kushtetues dhe sfidues. Krasniqi i LV-së thotë se

përbushja e qindra aktiviteteve operacionale, planifikimi dhe prokurimi i materialeve e shërbimeve brenda afateve të shkurtra kohore bartin rreziqe dhe e vështirësojnë menaxhimin efektiv të procesit zgjedhor. Ai përmend materialet e paasgjësuar të proceseve të kaluara, digjitalizimin e shërbimeve, aspektet logjistike, rekrutimin dhe trajnimin e zyrtarëve të sekretariatit, të Komisioneve Komunale Zgjedhore, si dhe të anëtarëve të këshillave të vendvotimeve dhe ekipeve të numërimit. "Në një rrethanë të tillë, organizimi i zgjedhjeve mbetet sfida serioze edhe për KQZ-në, si nga aspekti

teknik-administrativ, ashtu edhe ai i kapaciteteve njerëzore, që do të duhej të merret seriozisht në konsideratë para çfarëdo vendimmarrje politike apo institucionale, përfshirë edhe vetë aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese", shprehet Krasniqi.

Për Gashin e PDK-së sfida është edhe përbërja e plotë e KQZ-së, "përkatesisht mungesa edhe e një anëtarë nga opozita". "Gjithashtu, përppjekjet për ndërhyrje nga pushteti dhe mbajtja e anës nga kryesuesi, në mënyrë të verbër në favor të kërkesave të pushtetit, përbëjnë shqetësim. Për fat të keq, edhe disa anëtarë të tjerë, në pamundësi për ta ushtruar rolin

për të cilin janë deleguar, veprojnë në shërbim të pushtetit me ose pa vetëdije", thotë ai.

Nëntë anëtarë të KQZ-së u betuan para tani ish-presidentes, Vjosa Osmani, më 27 mars. Për emërimin e anëtarit të dhjetë ajo iu drejtua Gjykatës Kushtetuese, pasi LV-ja pretendoi se i takonin tre anëtarë në bazë të rezulttit zgjedhor. Edhe pas vendimit të Kushtetueses, që e shpalli të papranueshme kërkesën e Osmanit, boshllëku në KQZ nuk u mbyll. Pas përfundimit të mandatit presidencial të Osmanit, çështja ka mbetur në duart e ushtrueses së detyrës së presidentes, Albulena Haxhiu.

Policia trajnohet bashkë me KFOR-in për situata emergjente mjekësore

PRISHTINË, 22 PRILL - Zyrtarët e Policisë së Kosovës morën pjesë në trajnimin emergjent mjekësor të udhëhequr nga ushtarët e KFOR-it në Mitrovicën e Veriut. Sipas

njoftimit zyrtar të KFOR-it, trajnimi u përqendrua në teknikat e shpëtimit të jetës, duke përfshirë menaxhimin e rrugëve ajrore dhe lëvizjen e viktimave, forcimin e aftësisë

së reaguesve për të ofruar kujdes të menjëhershëm në situata kritike. "Aktivitete të tilla pasqyrojnë angazhimin e vazhdueshëm të KFOR-it me reaguesit e sigurisë lokale,

përkrahjen e zhvillimit profesional dhe rritjen e efektivitetit operacional në mbështetje të të gjithë njerëzve që jetojnë në Kosovë", thuhet në njoftim.



ORCA: QEVERIA RREZIKON PAVARËSINË E AGJENCISË SË KOSOVËS PËR AKREDITIM

Prishtinë, 22 prill - ORCA ka shprehur shqetësim të thellë për mënyrën se si, së fundmi, në procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, është rikthyer emri i Driton Velës, ish-kandidat për deputet nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje në zgjedhjet e vitit 2019.

ORCA thekson se në mënyrë të paprecedentë dhe jashtë çdo vëmendjeje publike, ky emër është kontrabanduar në listën e kandidatëve, duke anashkaluar transparencën dhe ekspertizën e organizatave që monitorojnë arsimin e lartë. "Ky zhvillim është veçanërisht alarmues duke pasur parasysh se bëhet fjalë për një institucion të pavarur, kredibiliteti i të cilit është thelbësor për cilësinë e arsimit të lartë në vend. ORCA rikujton se në vitin 2023, gjatë një procesi të mëhershëm për



përzgjedhje në këtë bord, Driton Vela ishte diskualifikuar pasi ishte kapur në flagrancë duke mashtruar komisionin përmes deklaratimeve të rreme në aplikim. Ky fakt, i dokumentuar dhe i bërë publik në atë kohë, e bën të pakuptimtë dhe të papranueshme rikthimin e tij

në një proces të ri për të njëjtin pozitë. Për më tepër, ORCA është e informuar për parregullsi të shumta në procesin aktual, duke përfshirë paqartësi serioze në lidhje me raportin e komisionit vlerësues dhe mënyrën e procedimit të tij drejt qeverisë dhe institucioneve të tjera", thuhet

në reagim.

Sipas ORCA-s, ky rast përbën një precedent të rrezikshëm të ndërhyrjes politike në institucione që duhet të jenë të pavarura dhe të bazuara në meritë. "Përfshirja e personave me histori të dokumentuar të mashtrimit në procese të tilla jo vetëm që dëmton besimin e publikut, por rrezikon të minojë përpjekjet e viteve të fundit për ngritjen e standardeve në arsimin e lartë dhe për rikthimin e kredibilitetit të Agjencisë së Akreditimit në nivel ndërkombëtar. Në këtë kontekst, ORCA rikujton ndërhyrjet e vitit 2017-2019 nga Qeveria e udhëhequr nga Ramush Haradinaj, të cilat çuan në cenimin e pavarësisë së Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe përfundimisht në përjashtimin e saj nga mekanizmat ndërkombëtarë të

sigurimit të cilësisë", thekson ORCA.

Në reagimin e tyre thuhet se zhvillimet aktuale tregojnë se qasja e kryeministrit aktual Albin Kurti nuk dallon në thelb nga ajo e paraardhësit të tij: ndërhyrja është e njëjtë, metoda është e njëjtë dhe rreziku për pasojat mbetet real. "ORCA shpreson që kësaj radhe rezultati të mos jetë i njëjtë dhe që Kosova të mos përballet sërish me izolim ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë. ORCA do të përdorë të gjithë mekanizmat në dispozicion për të ndaluar këtë përpjekje për kapje të një institucioni të pavarur, përfshirë edhe njoftimin zyrtar të përfaqësuesve ndërkombëtarë të ENQA dhe EQAR për situatën e krijuar. Çdo ndërhyrje e tillë rrezikon drejtpërdrejt jo vetëm integritetin", thuhet tutje.

PËRUROROHET TRANSFORMIMI I KLINIKËS SË KARDIOLOGJISË NË QKUK

Prishtinë, 22 prill - Kryeministri Albin Kurti së bashku me ministrin e Shëndetësisë, Arben Vitia dhe ambasadorin e Luksemburgut në Kosovë, Eric Dietz, morën pjesë në përfundimin e transformimit të Klinikës së Kardiologjisë në QKUK. Me këtë rast, kryeministri Kurti tha se ky investim prek drejtpërdrejt jetën dhe shëndetin e qytetarëve tanë dhe lehtëson trajtimin e pacientëve. "Një hapësirë prej rreth 400 metrash katrorë është transformuar sipas standardeve moderne spitalore, duke krijuar kushte më të mira për mjekët, specialistët, infermierët dhe mbi të gjitha, kushte më dinjitoze për shërim të plotë e më të shpejtë për pacientët tanë", tha ai, duke shtuar se

funksionalizimi i funksionalizimi i Cath-Lab-it bashkëkohor dhe vendosja e angiografit të ri, përbëjnë një hap të madh përpara në diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve kardiovaskulare. Kurti shprehu mirënjohje të thellë dhe falënderim të veçantë për qeverinë dhe popullin e Luksemburgut për mbështetjen e vazhdueshme ndaj sistemit shëndetësor dhe vendit tonë në përgjithësi, derisa theksoi se transformimi i njësive gjysmintensiv kardiologjike, i filluar më 8 prill, dëshmon përkushtimin tonë për transformimin e plotë të secilës klinikë dhe të secilit spital rajonal dhe, rrjedhimisht, të sistemit tonë të shëndetësisë publike në përgjithësi. Ndërkaq, ministri i

Shëndetësisë, Arben Vitia, u shpreh i lumtur për përfundimin e këtij renovimi. Ai falënderoi stafin e Klinikës së Kardiologjisë, edhe drejtorin e Klinikës, dr. Faik Shatri, të cilët kanë qenë motorët dhe nismëtarët që në bashkëpunim me miqtë nga Luksemburgu të fillojnë këtë renovim dhe ta përmbyllin gjithë renovimin e Klinikës së Kardiologjisë, e cila do të ketë kushte optimale për pacientët, duke shtuar numrin e atyre që diagnostikohen dhe trajtohen në këtë klinikë, duke përmirësuar kushtet e trajtimit, mbi të gjitha duke përmirësuar edhe kushtet e mjekëve, infermierëve dhe stafit mbështetës të cilët pa pushim japin shërbime çdo orë të çdo dite, për 365 ditë.



Prokuroria e Pejës për tre muaj ka ngritur 371 aktakuza kundër 458 personave

PEJË, 22 PRILL - Prokuroria Themelore në Pejë njofton opinionin publik se për periudhën tremujore janar, shkurt, mars, ka ngritur gjithsej 371 aktakuza, kundër 458 personave për vepra të

ndryshme penale. Nga Departamenti i Krimeve të Rënda, Departamenti i Përgjithshëm dhe për të Mitur, prokurorët e shtetit kanë ngritur 371 aktakuza ndaj 458 personave për lloje të ndryshme

të veprave penale nga Kodi Penal i Republikës së Kosovës. Mesatarja për muaj e ngritjes së aktakuzave është 124, kurse e personave të akuzuar rreth 153 persona të akuzuar për një muaj pune.

Prokuroria Themelore në Pejë mbetet e përkushtuar për luftimin e dukurive negative dhe të gjithë atyre personave që bien ndesh me ligjin komfor Kodit Penal të Republikës së Kosovës.



Abdixhiku mobilizon mërgatën: Koha për pritje ka përfunduar, koha për veprim ka nisur

Prishtinë, 22 prill - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka bërë me dije se ka zhvilluar një takim virtual me 88 nëndegët e kësaj partie në mërgatë. Ai i ka njoftuar për rrjedhën e proceseve negociuese në lidhje me presidentin, për të cilat tha se dështuan. "Përkundër vullnetit tonë maksimal dhe

kërkesave tona minimale - veç demokraci. Por ky dështim nuk është fund; është moment kthesë. Dhe atë kthesë e madhe për Lidhjen. Folëm hapur për momentin politik dhe për domosdoshmërinë e bashkimit të së djathtës brenda LDK-së; si rruga e vetme për ta kthyer drejtimin e vendit dhe për të ndërtuar një alternativë të denjë

për qytetarët. U dakordua për mobilizim të plotë dhe nisjen e menjëhershme të përgatitjeve për tubime e takime në mërgatë. Mërgata jonë nuk është vetëm mbështetje; është pjesë vendimtare e kthesës që po ndërtojmë. Koha për pritje ka përfunduar. Koha për veprim ka nisur", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook".



IKD-ja S'MERR PJESË NË KONSULTIMET 'FORMALE' PËR BYRONË: PO TENTOHET TË PROCEDOHEM ME NGUTI

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 22 PRILL - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka reaguar ndaj mënyrës se si Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit ka thirrur dëgjimin publik për Projektligjin nr. 10/L-019 për Byronë Shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme. Sipas IKD-së, përkundër faktit se tentativa për shmangie nga procedurat e rregullta parlamentare nuk është miratuar në seancë plenare, mënyra se si po zhvillohet tash ky proces dëshmon se po tentohet që një projektligj i një rëndësie të madhe që afekton të drejtat e njeriut të procedohet me nguti, pa dhënë kohën e nevojshme për një konsultim real, serioz dhe meritator të përmbajtjes së Projektligjit në fjalë. "Ftesa për pjesëmarrje në dëgjimin publik është publikuar vetëm më pak se 24 orë përpara takimit. Një qasje e tillë nuk mund të konsiderohet serioze dhe as në përputhje me standardet minimale të një konsultimi ku kërkohet kontribut përmbajtësor dhe profesional për një projektligj kaq të ndjeshëm. Me një afat kaq të shkurtër, pjesëmarrja e akterëve relevantë reduktohet në formalitet dhe jo në mundësi reale për të dhënë kontribut meritator në këtë proces. Në rastin konkret, duke qenë se Projektligji është duke u trajtuar sipas procedurës së rregullt, afati i përcaktuar për thirrjen e



dëgjimit publik është në kundërshtim me Nenin 38, paragrafi 7 të Rregullores së Kuvendit, i cili përcakton se ftesa për seancë dëgjimore duhet të shpallet në ueb-faqen e Kuvendit të paktën pesë (5) ditë para takimit, së bashku me agjendën, projektligjin që do të diskutohet dhe materialet përcjellëse", thuhet në këtë reagim.

IKD-ja ka theksuar se, siç dihet, ky Projektligj është rrëzuar dy herë në Gjykatën Kushtetuese, një herë për meritat e tij dhe një herë për procedurën e ndjekur. "Derisa trajtohet për herë të tretë në Kuvend, në dy (2) raste Qeveria nuk ka zhvilluar fare konsultime publike derisa në rastin tjetër ka shkurtuar në

mënyrë arbitrare afatin e konsultimeve publike. Në këto rrethana, duke pasur parasysh këto aspekte dhe rëndësinë e këtij projektligji, çdo veprim që reflekton nguti, formatitet apo përfshirje vetëm sa për të përmbushur një kërkesë procedurale, cenon seriozisht besueshmërinë e procesit dhe përmbajtjen e Projektligjit në fjalë", theksohet në reagimin e IKD-së, duke shtuar se zhvillimi i këtij dëgjimi publik në rrethana të tilla, kur vendi ndodhet vetëm pak ditë para një afati kur pritjet të shpërndahet Kuvendi, shton përshtypjen se qëllimi kryesor nuk është zhvillimi i konsultimeve meritore dhe gjithëpërfshirëse, por procedimi sa më i shpejtë i

Projektligjit. "Një ligj i tillë nuk duhet të trajtohet me nguti dhe as të shtyhet përpara përmes konsultimeve të organizuara në mënyrë të tillë që e bëjnë të pamundur pjesëmarrjen substanciale të shoqërisë civile dhe akterëve të tjerë relevantë. Për këto arsye, IKD vlerëson se pjesëmarrja në këtë dëgjim publik do të nënkuptonte vetëm validim të një tendence për procedim të përsheptuar, jo adekuat dhe përfshirje vetëm formale në konsultime publike. Prandaj, IKD njofton publikisht se nuk do të marrë pjesë në këtë takim", thuhet në reagim.

Ndër të tjera, IKD-ja ka vlerësuar se deri më tani ka dhënë kontribut të vazhdueshëm për këtë

projektligj, që nga koha e inicimit të tij. "Kjo duke marrë pjesë në të gjitha takimet e mbajtura, duke publikuar analiza, dërguar komente dhe marrë pjesë në takimet e Komisionit të Venecias përkitazi me këtë Projektligj. IKD mbetet e përkushtuar që të kontribuojë tutje në çdo proces serioz, të rregullt dhe gjithëpërfshirës të konsultimit publik, ku koha, forma dhe mënyra e organizimit të mundësojnë trajtim meritator të çështjeve të ngritura. Megjithatë, pjesëmarrja në procese të organizuara në mënyrë të ngutshme dhe formale nuk i shërben cilësisë së legjislacionit dhe interesit publik", është theksuar në reagimin e IKD-së.

Haxhiu kërkon përmbylljen sa më të shpejtë të procesit për zgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit

PRISHTINË, 22 PRILL - U. d. presidentja e vendit, Albulena Haxhiu, ka pritur në takim kryesuesin e Këshillit Prokurorial, Arian Gashi, me të cilin kanë diskutuar për arritjet dhe

sfidat me të cilat përballet sistemi prokurorial në vend. "Folëm për reformat në drejtësi dhe domosdoshmërinë e përmbylljes sa më të shpejtë të procesit për zgjedhjen e

Kryeprokurorit të Shtetit. Po ashtu folëm edhe për nevojat buxhetore, infrastrukturën, si dhe nevoja për më shumë prokurorë dhe staf mbështetës, çështje që ndikojnë në efikasitetin

institucional. Riafirmova përkushtimin për pavarësinë institucionale dhe forcimin e sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës", ka shkruar Haxhiu në "Facebook".



Zyrtarizohet marrëveshja e bashkëpunimit për zhvillimin e Akademisë së Turizmit në Kosovë

PRISHTINË, 22 PRILL - Gjatë Panairit Ndërkombëtar të Turizmit në Kosovë është zyrtarizuar një marrëveshje bashkëpunimi mes Unionit të Turizmit të Kosovës dhe institucionit britanik Stirling Centre for Strategic Learning and Innovation.

Sipas njoftimit të Unionit të Turizmit të Kosovës, ky partneritet është pjesë e një konsorciumi ndërkombëtar dhe synon transformimin e arsimit në fushën e turizmit dhe

mikpritjes, duke e orientuar atë drejt praktikës dhe standardeve bashkëkohore. “Ky partneritet synon ta transformojë arsimin në turizëm dhe mikpritje duke krijuar një sistem modern, inovativ dhe të orientuar drejt praktikës në përputhje me kërkesat e shekullit 21”, thuhet në njoftim.

Në fokus të marrëveshjes është krijimi i Akademisë së Turizmit, e cila pritet të sjellë qasje të re në përgatitjen profesionale në këtë

sektor. “Fuqizimi i të rinjve me aftësi praktike dhe të kërkuara në treg, mbështetja e bizneseve vendore me staf të kualifikuar, rritja e cilësisë së shërbimeve dhe promovimi i turizmit shëndetësor janë ndër objektivat kryesore”, theksohet më tej. Sipas Unionit të Turizmit të Kosovës, iniciativa synon të kontribuojë në zhvillimin ekonomik dhe në rritjen e konkurrueshmërisë së vendit si destinacion turistik.



KUSH DO TË KOMPENSOHET NGA PASAKTËSITË NË NJEHSORËT ELEKTRIKË?

PRISHTINË, 22 PRILL - Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka njoftuar se do të kompensohen të gjithë konsumatorët e dëmtuar nga pasaktësitë e mundshme tarifore në faturimin e energjisë elektrike, përkatësisht nga problemet e mundshme me njehsorët elektrikë në Kosovë. Përveç konsumatorëve, njehsorët e të cilëve janë verifikuar se kanë pasur pasaktësi, edhe konsumatorët e tjerë që dyshojnë se mund të jenë prekur nga këto pasaktësi kanë të drejtë të paraqesin ankesë, thanë për Radion Evropa e Lirë nga ky rregullator. Në rast se vërtetohet se janë dëmtuar, konsumatorët do të kompensohen. “Fillimisht, konsumatorët ankesat mund t'i paraqesin në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit [MINT], pastaj te Kompania Kosovare për Distribuim të Energjisë Elektrike [KEDS]. Nëse

nuk pajtohen me përgjigjet e tyre, ankesa mund të drejtohet në ZRRE”, thanë nga rregullatori. Çështja e njehsorëve është ngritur disa javë më herët, pasi partia opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe media lokale “Nacionale” publikuan gjetjet e hulumtimeve të tyre, rreth 2 mijë mostra në total, për mospërputhjet mes orës në njehsorët e rrymës me orën lokale.

Nga inspektimet në terren, pas shqetësimeve të ngritura për pasaktësi në njehsorë, MINTI ka bërë me dije se njehsorët e verifikuar kanë pasur afat të skaduar të vlefshmërisë dhe pasaktësi në datë dhe orë. Megjithatë, sipas kësaj ministrie, matjet e energjisë elektrike kanë rezultuar të jenë në rregull dhe pa ndikim në saktësinë e konsumit të regjistruar.

Radio Evropa e Lirë pyeti se sa mund të jetë vlera e kompensimit dhe, sipas ZRRE-



së, vlerat financiare ndryshojnë, por se ato janë të vogla.

Madje, sipas ZRRE-së, një numër i vogël i konsumatorëve mund të përfitojnë nga kompensimi, pasi pa vetëdije ata kanë përfituar tarifa të ulëta gjatë ditës.

Edhe në komunikatën për medie të këtij rregullatori, më 21 prill, thuhet se “në pjesën më të madhe të rasteve, korrigjimet financiare nuk kanë rezultuar në favor të konsumatorëve, por pavarësisht kësaj çdo rast do të trajtohet me seriozitet”.

Çmimi i energjisë elektrike në Kosovë ndryshon varësisht nga koha e shpenzimit.

Tarifa e lartë shfrytëzohet gjatë ditës dhe tarifa e ulët gjatë natës. Kjo e fundit gjatë dimrit aplikohet në periudhën 22:00-07:00, ndërsa gjatë verës nga ora 23:00-08:00. Sipas tarifave aktuale, konsumatorët familjarë që shpenzojnë deri në 800 kilovatë në orë (kWh) paguajnë 9.05 centë për kilovat, ndërsa 15.43 centë nëse e tejkalojnë këtë prag.

Gjatë tarifës së ulët konsumatorët e paguajnë 3.88 centë kilovatin, ndërsa 7.28 centë nëse e tejkalojnë shifrën prej 800 kilovatesh.

Më 16 prill MINTI ka gjobitur KEDS-in me 30 000 mijë euro për gjashtë njehsorë me afat të skaduar të vlefshmërisë.

KEDS-i i ka mohuar shkeljet, duke thënë se mospërputhjet janë çështje teknike dhe jo manipulim. Sipas KEDS-it, nëse kalimi në tarifë është bërë me disa minuta vonësë, atëherë edhe ka përfunduar më vonë.

ZRRE njëherësh në

komunikatën e lëshuar më 21 prill ritheksoi se KEDS-i dhe KESCO janë ndërmarrje të rregulluara dhe operojnë në përputhje me kornizën ligjore, gjë që e kufizon mundësinë për të përfituar nga gabimet eventuale në matjen e energjisë elektrike. “Gabimet eventuale nëse ndodhin mund të kenë efekt të përkohshëm deri në identifikimin dhe korrigjimin e tyre dhe çdo konsumator i prekur do të kompensohet plotësisht”, u tha në njoftim.

Po të martën Kuvendi i Kosovës ka debatuar për gjendjen në sektorin e energjisë në vend, në një seancë të jashtëzakonshme, mes shqetësimeve për çmimin e lartë të rrymës, mungesën e prodhimit dhe dyshimeve për manipulime me faturim.

Deputetë opozitarë e akuzuan qeverinë e kryeministrit Albin Kurti për, siç thanë, gjendjen e rënduar në sektorin e energjisë, akuza që u hodhën poshtë nga kabineti qeverisës.

KOSOVA DHE MAQEDONIA E VERIUT AVANCOJNË BASHKËPUNIMIN NDËRKUFITAR PËR MENAXHIMIN E UJËRAVE



PRISHTINË, 22 PRILL - Institucionet e Kosovës dhe të Maqedonisë së Veriut kanë zhvilluar një tryezë të përbashkët dyditore, me fokus forcimin e bashkëpunimit ndërkufitar në menaxhimin e ujërave në pellgjet lumore Lepenc dhe Vardar.

Takimi është organizuar me mbështetjen e Programit IWRM-K dhe Programit për Menaxhimin, Përdorimin dhe

Mbrojtjen e Ujërave Nëntokësore në Maqedoninë e Veriut, duke bashkuar përfaqësues të ministrive përkatëse, autoriteteve të pellgjeve lumore, shërbimeve hidrometeorologjike dhe ekspertëve teknikë nga të dyja vendet.

Gjatë tryezës diskutimet janë përqendruar në analizimin e përvojave nga bashkëpunimi

ekzistues ndërkufitar, përmirësimi i shkëmbimit të të dhënave dhe informacionit, si dhe në identifikimi i prioriteteve konkrete për bashkëpunim në të ardhmen. Sipas organizatorëve, ky takim përbën një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të besimit dhe krijimit të një kornize më praktikë bashkëpunimi në nivel lokal për pellgjet lumore

Lepenc dhe Vardar, me theks në mësimin e përbashkët dhe shkëmbimin teknik.

Programi IWRM-K ka theksuar se mbetet i përkushtuar për t'i mbështetur proceset që kontribuojnë në forcimin e bashkëpunimit ndërkufitar, përmirësimin e qeverisjes së ujërave dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve të përbashkëta ujore.

Themelohet Garda për Mbrojtjen e Natyrës


PRISHTINË, 22 PRILL - Në Ditën Botërore të Tokës, në një ceremoni solemne me pjesëmarrjen e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe ministrit të Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, si dhe përfaqësuesve të organizatave mjedisore, u nënshkrua memorandumi i bashkëpunimit për themelimin e Gardës për

Mbrojtjen e Natyrës. Ministri e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fitore Pacolli, ka theksuar se kjo Gardë bashkon zërat më autentikë të terrenit, peshkatarë, bjeshkatarë, fotografë të jetës së egër, aktivistë dhe gardianë juniorë, në një angazhim të përbashkët për mbrojtjen e mjedisit. “Përballë sfidave si ndryshimet klimatike,

degradimi i ekosistemeve dhe ndotja, kjo iniciativë synon forcimin e monitorimit, parandalimin e dëmeve dhe rritjen e ndërgjegjësimit qytetar. Garda për Mbrojtjen e Mjedisit tashmë i ka rreth 100 gardianë të rinj, prej të cilëve 30 janë fëmijë, të angazhuar në kujdesin dhe mbrojtjen e natyrës”, ka deklaruar Pacolli.



KOSTOJA E LUFTËS NË IRAN, BE-ja PËRBALLET ME NJË FATURË SHITESË PREJ 28 MILIARDË DOLLARËSH



Evropa gjendet sërish në një udhëkryq ekonomik. Pasoja të luftës në Iran po kthehen me shpejtësi në një barrë financiare marramendëse për kontinentin, i cili sapo kishte filluar të merrte frymë pas krizës së shkaktuar nga pushtimi i Ukrainës nga Rusia në vitin 2022.

Komisioni Evropian zbuloi të mërkurën një seri masash emergjente për të mbrojtur ekonominë nga rritja e faturave të energjisë. “Për herë të dytë në më pak se pesë vjet, evropianët po paguajnë çmimin e varësisë nga lëndët djegëse fosile të importuara”, deklaroi krahu ekzekutiv i BE-së. Sipas të dhënave, blloku ka shpenzuar 24 miliardë euro (28 miliardë dollarë) shtesë vetëm nga rritja e çmimeve – rreth

587 milionë dollarë çdo ditë – pa blerë asnjë molekulë shtesë energjie.

Masat e BE-së: Koordinim dhe ndërhyrje emergjente

Për të përballuar goditjen, BE planifikon ngritjen e një organi pan-evropian që do të identifikojë dhe koordinojë mungesat e karburantit, si dhe menaxhimin e rezervave kombëtare.

Sektori i Aviacionit në Rrezik

Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë dhe ACI Europe kanë paralajmëruar për mungesa të mundshme të

karburantit të avionëve. Evropa importon rreth 70% të nevojave të saj. Grupet e industrisë kanë bërë thirrje për “pezullim urgjent të taksave të aviacionit” për të mbajtur çmimet nën kontroll. Kompani si Lufthansa njoftuan shkurtimin e 20,000 fluturimeve deri në tetor për shkak të dyfishimit të çmimit të karburantit. Nga ana tjetër, gjiganti kimik BASF ka rritur çmimet deri në 30% për produkte jetësore, ndërsa industria kimike gjermane paralajmëron mbyllje fabrikash dhe shkurtime të vendeve të punës.

Mbijetesa po bëhet e vështirë edhe për peshkatarët. BE-ja ka aktivizuar një “mekanizëm krize” për t’i ofruar këtij sektori mbështetje direkte financiare,

pasi kostot e karburantit po pamundësojnë nxjerrjen e prodhimeve të detit në treg.

Rreziku i recesionit dhe ndikimi te konsumatorët

Neil Shearing, kryeekonomist në Capital Economics, paralajmëron se vazhdimi i luftës me Iranin në gjysmën e parë të këtij viti mund ta zhysë Evropën në recesion të plotë. Fondi Monetar Ndërkombëtar tashmë ka ulur parashikimet e rritjes ekonomike për 21 vendet e Eurozonës dhe ka rishikuar ndjeshëm në rënie zhvillimin e Mbretërisë së Bashkuar.


Në Britaninë e Madhe, inflacioni u rrit sërish këtë muaj. Presioni i çmimeve në

pompa nuk është veçse “vala e parë e shokut”, thotë ekonomisti Adam Deasy. Sipas tij, faza e dytë do të godasë nënproduktet kritike: plehrat bujqësore, plastikën dhe metalet. Situata ka prekur edhe sektorin shëndetësor dhe ushqimor me mungesa thelbësore të dioksidit të karbonit (CO2), një nënprodukt i plehrave kimikë, tregu i të cilëve është bllokuar nga rritja e gazit.

Përballë kësaj situatë, qeveritë e Evropës, përfshirë Londrën, po nxitojnë të shtojnë kapacitetet vendase për energjinë diellore dhe të rinovueshme, një orvatje e dëshpëruar për të mbajtur “të ndezur” ekonominë e kontinentit në prag të krizës së radhës. /CNN

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com




QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Etnik Brruti pritet të transferohet te Hajduku i Splitit

SPLIT, 22 PRILL - Etnik Brruti është duke e luajtur sezonin e tij të fundit te skuadra e Malishevës, pasi do të largohet nga futbolli i Kosovës në verë për ta vazhduar karrierën në Kroaci. Në afatin kalimtar të verës, Brruti do të transferohet te gjiganti kroat,

Hajduku i Splitit, kanë raportuar mediumet në Kroaci.

Edhe pse ishte raportuar se Brruti kishte marrëveshje me Rijekën, mësohet se Hajduku tashmë ka siguruar shërbimet e mesfushorit 22-vjeçar.

Palët tashmë kanë arritur

marrëveshje dhe Brruti me Hajdukun do të firmosë kontratë trevjeçare, ndërsa ekipit kroat do t'i bashkohet si lojtar i lirë pasi në fund të sezonit i skadon kontrata me Malishevën. Brruti është një prej lojtarëve kyç të Malisheva, por

edhe ndër mesfushorët më të vlerësuar në Superligën e Kosovës.

Në sezonin aktual Brruti ka 9 gola e 3 asistime në kampionatin e Kosovës, kurse për Kombëtaren U21 të Shqipërisë ka realizuar 2 gola në 8 paraqitje.



KOSOVA NGJITET NË POZITËN MË TË MIRË HISTORIKE NË RANGLISTËN E FIFA-S

PRISHTINË, 22 PRILL - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll për femra ka shënuar një ngritje të jashtëzakonshme në ranglistën e FIFA, duke regjistruar rritjen më të madhe të pikëve në nivel global për këtë periudhë. Falë fitoreve ndaj Gjibraltarit dhe Kroacisë, si dhe dy triumfeve radhazi ndaj Bullgarisë, Kosova ka grumbulluar plot 58.33 pikë, duke e pasur rritjen më të lartë nga të gjitha përfaqësueset që prej publikimit të fundit të renditjes më 11 dhjetor 2025. Në ranglistën e re të publikuar të martën nga FIFA, Kosova renditet në pozitën e 81-të,

duke u ngjitur për 11 vende krahasuar me renditjen paraprake. Kjo është njëkohësisht pozita më e mirë historike për "Dardanet". Të gjitha këto rezultate pozitive janë arritur në kuadër të kualifikimeve për Kupën e Botës 2027, duke dëshmuar formën në rritje dhe përparimin e vazhdueshëm të përfaqësueses. Deri më tani pozita më e mirë e Kosovës kishte qenë e 91-të, e arritur në mars të vitit 2024, ndërsa më e dobëta ishte vendi i 126. Mesatarja e renditjes së Kosovës ndër vite ka qenë pozita e 108.



MALLORCA KËRKON 30 MILIONË EURO PËR MURIQIN



Mallorca, 22 prill - Në ndeshjen e fundit të Mallorcas nuk ka shënuar gol, por sulmuesi Vedat Muriqi vazhdon të jetë shumë i përfolur në Spanjë. Ditët e fundit është raportuar vazhdimisht për një kalim të mundshëm të Muriqit te Barcelona apo Fenerbahçe në Turqi. Madje mediumet turke kanë raportuar se palët kanë marrëveshje në parim dhe se Fenerbahçe së shpejti do ta kontaktojë Mallorcan.

Mirëpo secila skuadër që e do Muriqin në radhët e veta, përfundimisht nuk do ta ketë

aspak lehtë arritjen e marrëveshjes me Mallorcan. Klubi nga La Liga ka bërë me dije se çmimi minimal për transferimin e Muriqit në afatin kalimtar të verës është 30 milionë euro. Muriqi ka 21 gola këtë sezon dhe Mallorca po dëshiron ta mbajë sulmuesin e Kosovës në radhët e veta pasi ka kontratë deri në vitin 2029. Mbetet të shihet nëse Mallorca do të marrë ofertë prej 30 milionë eurosh për Muriqin pas përfundimit të sezonit aktual apo 31-vjeçari do të jetë pjesë e klubit edhe sezonin e ardhshëm.

Rënia dramatike e Leicester Cityt - nga maja e futbollit anglez në humnerën e ligës së tretë

LEICESTER, 22 PRILL - Skuadra që kishte tronditur botën duke fituar Premierë Ligën në mënyrë sensacionale në sezonin 2015/16, tashmë ka prekur fundin. Leicester City ka rënë në League One, që i bie niveli i tretë i futbollit në Angli. Sezoni ka rezultuar katastrofik për "Dhjelprat", të cilat kanë grumbulluar shumë pak pikë dhe janë karakterizuar nga një numër i lartë humbesh, duke mos arritur në asnjë çast

stabilitet. Forma e dobët gjatë gjithë kampionatit i ka kushtuar rëndë, ndërsa mbrojtja e brishtë dhe mungesa e efikasitetit në sulm ishin faktorët kryesorë të dështimit. Goditja finale ka ardhur në ndeshjen e fundit të sezonit, ku Leicester City nuk ka arritur më shumë se një barazim, një rezultat që ka vulosur matematikisht rënien. Edhe pse kishte ende një fije shprese për mbijetesë, ajo

është shuar përfundimisht pas këtij hapi fals. Kjo rënie shënon një nga historitë më të dhimbshme në futbollin modern: nga kampionët e Anglisë dhe pjesëmarrës në Ligën e Kampionëve, në një skuadër që tashmë duhet të rindërtohet nga League One. Leicester City tani përballet me një mision të vështirë rikthimi, duke kërkuar të ringjallet dhe ta rikthejë lavdinë e humbur.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës / Tužilački Savet Kosova / Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 2 paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 2 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nenit 18 dhe nenit 21 të Rregullores Nr. 08/2024 për Transferimin dhe Avancimin e Nëpunësve Civil në Administratën e Sistemit Prokurorial, Rregullores Nr. 03/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuere për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Prokurorial, Rregullores Nr.05/2026 për Klasifikimin e Vendeve të Punës të Administratës në sistemin prokurorial, dhe në bazë të vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës DPSKPK/Nr. 157/2026 të datës 17 prill 2026, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

KONKURS I BRENDSHËM
AVANCIM NË KARRIERË
Nr. 05/2026

I. Titulli i vendit të punës:	Udhëheqës i Zyrës për Menaxhimin e Lëndëve
Emërtimi i pozitës:	Drejtues i ulët 1
Grupi, klasa, koeficienti/paga bazë:	P 12 8.6
Institucioni/Njësia:	Prokuroria Themelore Prishtinë
Numri i pozitave:	Një (1) pozitë
Kohëzgjatja e Emërimit:	Pa afat
Afati për aplikim:	22.04.2026 – 28.04.2026

Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

- Menaxhon punën e përgjithshme të Zyrës për Menaxhim të Lëndëve, mbikëqyr dhe organizon punën e stafit me ndarje të detyrave të punës, kujdeset që regjistrimi në libra dhe në mënyrë elektronike të jetë i saktë dhe pa gabime;
- Menaxhon me stafin e zyrës dhe organizon punën në bashkëpunim me Administratorin, monitoron dhe ofron udhëzime për punë të stafit duke ofruar shërbime cilësore nga zyra dhe vartësit;
- Në bashkëpunim me Administratorin, bënë vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme, rekomandon ndryshime, përmirësime me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës;
- Menaxhon ofrimin e produkteve e të shërbimeve në fushën administrative e të mbajtjes së evidencave të Zyrës për Menaxhim të Lëndëve, kujdeset për kryerjen e detyrave tjera të besueshme të cilat kërkojnë konfidencialitet;
- Ndihmon dhe propozon zhvillimin e politikave lidhur me Zyrën në bashkëpunim me menaxherët e nivelit qendror edhe me Administratorin;
- Koordinon punën me nivelin qendror lidhur me kërkesat dhe evidencat që kërkojnë brenda institucionit Prokurori i Shtetit dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës, ndërsa me lejin e Kryeprokurorit ofron edhe të dhëna për palët tjera jashtë institucionit;
- Bënë vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrjen e tij/saj dhe përkrah zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerjen e detyrave në përputhje me standardet e kërkuara, udhëheqësi i Zyrës për Menaxhim të Lëndëve i përgjigjet dhe i raporton administratorit;
- Kryen edhe punë tjera shtesë nga rasti në rast që ndërlidhen me punën e Zyrës sipas kërkesës së administratorit dhe Kryeprokurorit.

Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojnë të paktën njërin nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse në pikëpamje shëndetësore;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë;
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës;
- Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë rregullore.

Kriteret specifike shtesë, nëse ka:

- Nuk ka.

Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit:

- Njohuri të gjera dhe të thella të politikave, legjislacionit, procedurave sipas veprimtarisë që mbulon njësia përkatëse.
- Aftësi organizative dhe drejtuese për të menaxhuar njësinë organizative.
- Aftësi për t'iu përshtatur prioriteteve dhe kërkesave, afateve kohore përmes aftësive analitike dhe zgjidhjes së problemeve.
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësinë për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie besimi me eprorin dhe stafin që menaxhon.
- Aftësi për të motivuar stafin dhe për të menaxhuar me sukses projektet e njësisë përkatëse.
- Diplomë Universitare – Fakulteti Juridik, Ekonomik ose Administratë Publike.
- Tri (3) vite përvojë pune profesionale.

Kriteret për avancim në karrierë të nëpunësit civil në sistemin prokurorial janë:

- Plotësimi i kërkesave profesionale dhe kualifikimet e kërkuara për pozitën përkatëse;
- Kalimi me sukses i testit me shkrim dhe intervistës;
- Rezultatet e vlerësimit në punë për tre (3) vjetët e fundit që duhet të jenë: arrin pritshmërinë, tejkalon pritshmërinë ose arritje e jashtëzakonshme;
- Të mos jetë në procedurë disiplinore;
- Të mos jetë i ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore në tre (3) vjetët e fundit dhe
- Të mos jetë iniciuar ndonjë procedurë penale.

Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre:

- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës.
- Kopja e diplomës të kërkuar me konkurs dhe të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;
- Kopjet e dëshmisë se punësimi;
- Kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim, të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.
- Aplikacioni se bashku me dokumente dorëzohen në mënyrë fizike, elektronike dhe përmes postës.

Dëshmitë që nuk kërkohen gjatë aplikimit, por në fazën e verifikimit para emërimit:

- Certifikatë mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohej se nuk është i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më të vjetër se (6) muaj nga data e lëshimit.
- Dëshmi se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore.
- Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar.

Mënyrën e vlerësimit të kandidatëve:

- Verifikimi paraprak.
- Vlerësimi profesional (testim me shkrim dhe intervistë).

Mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët:

- Përmes ueb faqes së institucionit në mënyrë elektronike
- Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuara dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP;
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.
- Kandidati përmes aplikacionit deklaron dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e të gjitha dokumenteve të dorëzuara siç kërkohen nga shpallja e procedurës së rekrutimit.
- Deklarimi i rrejshëm sipas këtij neni paraqet shkas për përjashtim nga procedura e rekrutimit.

Kandidatët që aplikojnë në dy apo më shumë pozita duhet që për secilën pozitë të dorëzojnë aplikacionin së bashku me dokumentacionin e duhur.

Konkursi është i hapur 5 ditë pune nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës, nga data **22.04.2026 deri më 28.04.2026**.

Aplikacioni së bashku me dokumentet mbështetëse mund të dorëzohet në Sekretariatit e Këshillit në formë fizike, përmes postës ose postës elektronike, i cili regjistrohet dhe secili kandidat pajiset me një konfirmim mbi pranimin e aplikacionit.

Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00, në Divizionin për Staf Administrativ, kati IV, objekti i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, rruga "Luan Haradinaj", 10000 Prishtinë, Kosovë si dhe përmes postës elektronike: burimet.njerezore@rks-psl.org

Aplikimi përmes postës: Aplikacionet e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në Departamenti i Burimeve Njerezore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, adresa: Rr. "Luan Haradinaj", kati i IV, objekti i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038/200 66048, 038/200 66029, 038/200 66051, 038/200 66028, prej orës 08:00 – 16:00.

Vetëm kandidatët që kanë aplikuar brenda afatit dhe që i kanë dorëzuar të gjitha dokumentet sipas konkursit kanë të drejtë t'i nënshtrihen procesit të avancimit. Ndërsa, kandidatët të cilët nuk kanë aplikuar brenda afatit të paraparë në konkurs, si dhe ata të cilët kanë aplikuar në afat, por nuk e kanë dorëzuar dokumentacionin e kompletuar sipas kriterëve dhe kërkesave të konkursit, nuk do të merren parasysh.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës / Tužilački Savet Kosova /
Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Na osnovu člana 31. Zakona br. 06/L-056 o Tužilačkom Savetu Kosova, člana 2. stava 3. Zakona br. 08/L-197 o javnim službenicima, člana 2. stava 3. Zakona br. 08/L-196 o platama u javnom sektoru, člana 18. i člana 21. Pravilnika br. 08/2024 o premeštaju i napredovanju državnih službenika u administraciji tužilačkog sistema, Pravilnika br. 03/2024 o postupku zapošljavanja, prijema, imenovanja i probnog rada za zaposlene u administraciji Tužilačkog sistema, Pravilnika br. 05/2026 o Klasifikaciji administrativnih poslova u tužilačkom sistemu, i na osnovu Odluke Generalnog Direktora Sekretarijata Tužilačkog Saveta Kosova DPSKCP/br. 157/2026 od 17. aprila 2026. godine, Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova ovim objavljuje:

INTERNA KONKURS NAPREDOVANJE U KARIJERI Br. 05 /2026

I. Naziv radnog mesta:	Šef Kancelarije za Upravljanje Predmetima
Naziv pozicije:	Mlađi menadžer 1
Grupa, klasa, koeficijent/osnovna plata:	P 12 8.6
Institucija/Jedinica:	Osnovno Tužilaštvo Priština
Broj pozicija:	Jedna (1) pozicija
Trajanje imenovanja:	Bez roka
Rok za prijavu:	22.04.2026. – 28.04.2026.

Opšti opis posla:

- Upravlja celokupnim radom Kancelarije za upravljanje predmetima, nadgleda i organizuje rad osoblja podelom radnih zadataka, osigurava da je evidentiranje u knjigama i elektronski tačno i bez grešaka;
- Upravlja osobljem kancelarije i organizuje rad u saradnji sa administratorom, prati i daje uputstva za rad osoblja, pružajući kvalitetne usluge iz kancelarije i podređenima;
- U saradnji sa Administratorom, procenjuje interne procese i procedure, predlaže promene i poboljšanja kako bi se povećala efikasnost i kvalitet rada;
- Upravlja pružanjem proizvoda i usluga u administrativnom i evidencijskom području Kancelarije za upravljanje predmetima, osigurava obavljanje drugih poverljivih zadataka koji zahtevaju poverljivost;
- Pomaže i predlaže razvoj politika vezanih za Kancelariju u saradnji sa menadžerima na centralnom nivou i Administratorom;
- Koordinira rad sa centralnim nivoom u vezi sa zahtevima i dokazima potrebnim unutar Državnog tužioca i Tužilačkog saveta Kosova, dok uz dozvolu Glavnog tužioca, takođe pruža podatke drugim stranama izvan institucije;
- Vrši redovne evaluacije osoblja pod svojim nadzorom i podržava njihov razvoj kroz obuku za obavljanje zadataka u skladu sa potrebnim standardima, šef Kancelarije za upravljanje predmetima odgovara i izveštava administratoru;
- Isti takođe povremeno obavlja i druge dodatne zadatke vezane za rad kancelarije na zahtev administratora i glavnog tužioca.

Opšti kriterijumi za prijem na funkciju:

- Da bude državljanin Republike Kosovo;
- Da ima punu sposobnost delovanja, u skladu sa važećim zakonodavstvom;
- Da tečno govori najmanje jedan od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- Da bude u stanju da izvrši relevantni zadatak sa zdravstvene perspektive;
- Da ne bude osuđivan/a da je počinio/la krivično delo sa umišljajem;
- Da nema na snazi neku disciplinsku meru zbog ozbiljnih povreda;
- Da poseduje obrazovanje, profesionalno radno iskustvo i/ili veštine potrebne za poziciju; relevantnu kategoriju, klasu ili grupu;
- Da uspešno prođe procedure prijema utvrđene ovim pravilnikom.

Dodatni specifični kriterijumi, ako ih ima:

- Nema nijednog.

Znanja, veštine i kvalitete potrebne u postupku zapošljavanja:

- Široko i dubinsko poznavanje politika, zakonodavstva i procedura u skladu sa aktivnošću koju pokriva odgovarajuća jedinica.
- Organizacione i liderske veštine za upravljanje organizacionom jedinicom.
- Sposobnost prilagođavanja prioritetima i zahtevima, rokovima kroz analitičke veštine i veštine rešavanja problema.
- Komunikacijske veštine i lični uticaj, uključujući sposobnost stvaranja i održavanja odnosa poverenja sa nadređenima i osobljem kojim upravljaju.
- Sposobnost motivisanja osoblja i uspešnog upravljanja projektima relevantne jedinice.
- Univerzitetska diploma – Pravni, Ekonomski ili Fakultet Javne Uprave.
- Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva.

Kriteriji za napredovanje državnih službenika u tužilačkom sistemu su:

- Ispunjavanje profesionalnih uslova i kvalifikacija potrebnih za odgovarajuću poziciju;
- Uspešno položen pismeni test i intervju;
- Rezultati procene učinka za poslednje tri (3) godine koji moraju: ispunjavati očekivanja, premašivati očekivanja ili biti izuzetni;
- Da nije u disciplinskom postupku;
- Da nije kažnjen/a bilo kakvom disciplinskom merom u poslednje tri (3) godine i
- Da nema pokrenut nijedan krivični postupak.

Dokumenti koji se moraju dostaviti kao deo prijave i kako ih dostaviti:

- Kopija lične karte/pasoša/uverenja o državljanstvu Republike Kosovo.
- Kopija diplome tražene konkursom i podaci od obrazovnih ustanova, potvrda o nostrifikaciji diplome stečene u inostranstvu ili akt kojim se dokazuje da je diploma stečena u inostranstvu u postupku nostrifikacije, pod uslovom da se nostrifikacija diplome dostavi do trenutka potpisivanja akta za imenovanje na poziciju;
- Kopije dokaza o zaposlenju;
- Kopije dokumenata kojima se dokazuje ispunjavanje uslova za prijavu, kako je navedeno u oglasu za zapošljavanje i navedeno u prijavi.
- Prijava zajedno sa dokumentima se podnosi fizički, elektronski i poštom.

Dokazi koji nisu potrebni prilikom prijave, već u fazi provere pre imenovanja:

- Originalna potvrda o krivičnim kaznama izdata od strane suda kojom se dokazuje da optuženi nije osuđen da je počinio krivično delo sa umišljajem, ne starija od 6 (šest) meseci od datuma izdavanja.
- Dokaz da je kandidat zdravstveno sposoban.
- Relevantni dokazi da kandidat ima punu poslovnu sposobnost.

Način ocenjivanja kandidata:

- Preliminarna verifikacija.
- Stručna procena (pismeni test i intervju).

Način obaveštavanja i komunikacije sa kandidatima:

- Elektronskim putem putem web stranice institucije
- Nevećinske zajednice i njihovi pripadnici, osobe sa invaliditetom i nedovoljno zastupljeni pol imaju pravo na pravednu i proporcionalnu zastupljenost u državnoj službi Kosova, kako je navedeno u ZJS;
- Prijave podnesene nakon isteka roka neće biti prihvaćene, a nepotpune prijave će biti odbačene.
- Kandidat, putem prijave, izjavljuje i snosi odgovornost za autentičnost svih dostavljenih dokumenata kako je propisano oglasom za postupak zapošljavanja.
- Lažna izjava prema ovom članu predstavlja osnov za isključenje iz postupka zapošljavanja.

Kandidati koji se prijavljuju za dve ili više pozicija moraju podneti prijavu za svaku poziciju zajedno sa odgovarajućom dokumentacijom.

Konkurs je otvoren 5 radnih dana od dana objavljivanja na službenoj web stranici Tužilačkog sistema Republike Kosovo, od dana **22.04.2026. do 28.04.2026.**

Prijava, zajedno sa pratećom dokumentacijom, može se podneti Sekretarijatu Tužilačkog saveta Kosova u fizičkom obliku, putem pošte ili e-maila, što se evidentira i svaki kandidat dobija potvrdu o prijemu prijave.

Prijave se podnose svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 sati, Odeljenju za administrativno osoblje, IV sprat, zgrada Specijalnog tužilaštva, ulica „Luan Haradinaj“, 10000 Priština, Kosovo, kao i putem e-pošte na: human.resources@rks-psh.org

Prijava poštom: Popunjene prijave sa dokumentima mogu se dostaviti i poštom Odeljenju za ljudske resurse Sekretarijata Tužilačkog Saveta Kosova, adresa: Ulica „Luan Haradinaj“, 4. sprat, zgrada Specijalnog tužilaštva Republike Kosovo.

Prijave poslane poštom, koje imaju poštanski žig poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se važećim i biće razmotrene ako stignu u roku od 4 dana; prijave pristigle nakon ovog roka i nepotpune prijave se neće uopšte razmatrati.

Po potrebi nas možete kontaktirati na: tel: 038/200 66048, 038/200 66029, 038/200 66051, 038/200 66028, od 08:00 do 16:00 sati.

Samo kandidati koji su se prijavili u roku i koji su dostavili svu dokumentaciju u skladu s konkursom imaju pravo da prođu proces zapošljavanja. U međuvremenu, kandidati koji se nisu prijavili u roku koji je predviđen konkursom, kao i oni koji su se prijavili u roku, ali nisu dostavili kompletnu dokumentaciju u skladu sa kriterijumima i zahtevima konkursa, neće biti uzeti u obzir.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

